Nr. 7 prot
dt. 28/02/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

# VENDIM

Nr. 6, datë 23.02.2023

**PËR**

**MIRATIMIN ME KUSHT TË KËRKESËS PËR LEJE "KËRKESËPËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË (NË RASTIN E UJËRAVE TË RRJEDHSHËM) NË RASTIN KUR PËRDORIMI ËSHTË PËR >5 TON/VIT, >5 L/SEK",TË SUBJEKTIT "ARMANDO HYSAJ".**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin me kushtin e vendosur në pikën 3 (tre) të këtij projektvendimi, të kërkesës për leje "Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshëm) në rastin kur përdorimi është për >5 ton/vit, >5 l/sek", të subjektit "Armando Hysaj", me vendndodhje: Fshati Selcë, Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Lumi Cem i Selcës

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH):

- X = 465851
- Y = 4705372
- Z = 332 m.m.n.d

Prurja mesatare vjetore: Q= 1890 l/sek

Sasia e ujit që jepet për përdorim: Q= 100 l/sek

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për akuakulturë (rritje intensive e peshqve).

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

- X = 465715
- Y = 4705147
- Z = 322 m.m.n.d

Vëllimi i rrjedhës së kthyer: Q= 100 l/sek

3. Kjo leje jepet me kushtin e lidhjes së kontratës së ushtrimit të aktivitetit me ministrinë përgjegjëse, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e akuakulturës.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR
DRIN-BUNË